



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:055563

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05448720

P.nr. 274/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i përgjithshëm - Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Sabit Sadikaj, me bashkëpunëtorin profesional Asdren Selmani, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarve, A.M dhe L.S për shkak të veprës penale "Posedim i paautorizuar i narkotikeve" nga neni 269, paragrafi 2, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), të akuzuar sipas aktakuzës me kërkesë për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor të Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.5043/2023 të datës: 14.02.2024, gjykata jashtë seancë më datë: 28.02.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.5043/2023 të datës: 14.02.2024, si dhe kjo gjykatë komfor nenit 495 të KPPRK-së, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të akuzuarve:

1.A.M nga babai I dhe nena M, mbiemri i vajzërisë S, i lindur me datë "data e lindjes", në Prishtinë, ku jeton me adresë të vendbanimit ne "vendbanim", me numër personal të letërnjoftimit "letërnjoftim", i pa martuar, të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i nacionalitetit shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës

2.L.S nga i babi M dhe nëna H, mbiemri i vajzërisë N, i lindur më datë: "data e lindjes", në fshatin Ballaban, jeton me adresë të vendbanimit ne Rr "rruga" në Fushë Kosovë, me numër personalë të letërnjoftimit: "letërnjoftim", i pa martuar, të kryer shkollën e fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, i nacionalitetit shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës

JANË FAJTOR

S e p s e:

I. Me datë 07.07.2023 rreth orës 02:30 në Prishtinë, rruga “rruga” i pandehuri A.M, pa autorizim ka poseduar substancë narkotike në atë mënyrë që, zyrtaret policor gjatë pikë kontrollit kanë ndaluar veturën e tipit “tipi” me targa “targa” të cilën kanë qenë duke e drejtuar D.B dhe dy pasagjerët A.M dhe L.S , dhe gjatë kontrollit tek i pandehuri A.M i është gjetur një cigare e dyshuar për substancë narkotike, dhe një grinder (për grirjen e mariuhanës) të cilën e sekuestron përkohësisht policia përmes vërtetimit, me ç’rast sipas raportit të ekspertit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, Dëshmia #1 ka rezultuar se është substancë narkotike e llojit kanabis (Mariuhanë) e cila përmban tetrahidrokanabinol (THC) pesha neto e përgjithshme: $0.40 = 0.0001$ gram,

-me çka i pandehuri A.M ka kryer veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2, i Kodit Penal të Kosovës(KPRK)

II. Me datë, kohë, vend dhe mënyrë si në dispozitivin të I, i pandehuri L.S pa autorizim ka poseduar substancë narkotike në atë mënyrë që, gjatë kontrollit tek i pandehuri i është gjetur një cigare e dyshuar për substancë narkotikë të cilën e sekuestron përkohësisht policia përmes vërtetimit, me ç’rast sipas raportit të ekspertit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, Dëshmia #2, ka rezultuar se është substancë narkotike e llojit Kanabis (Mariuhanë) e cila përmban tetrahidrokanabinol (THC) pesha neto e përgjithshme: $0.21=0.0001$ gram,

-me çka i pandehuri L.S ka kryer veprën penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 184 par. 1 dhe 321 par. 1 të KPRK, si dhe neneve 365 dhe 493, 495, 496, të KPPRK-së, të akuzuarin e gjykon me:

DËNIM ME GJOBË

- I. I akuzuari, A.M për veprën e parë penale të përcaktuar si në pikën I të këtij dispozitivit të këtij aktgjykim “Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269, paragrafi 1 të KPRK-së, dënohet me gjobë në shumën prej 300 € (treqind euro) të cila gjobë duhet të paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë.
- II. Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 par 3 të KPRK-së, do ta zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me 20 € (njëzet euro) gjobë.
- III. I akuzuari, L.S për veprën e parë penale të përcaktuar në këtë aktgjykim “Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269, paragrafi 2 të KPRK-së, dënohet me gjobë në shumën prej 250 € (dyqind e ë euro). të cila gjobë duhet të paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë.

- III. Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 par 3 të KPRK-së, do ta zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me 20 € (njëzet euro) gjobë.
- IV. URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i substancës të llojit kanabis (Mariuhanë) e cila përmban tetrahidrokanabinol (THC) pesha neto e përgjithshme: 0.40 = 0.0001 gram, si dhe substancë narkotike e llojit Kanabis (Mariuhanë) e cila përmban tetrahidrokanabinol (THC) pesha neto e përgjithshme: 0.21=0.0001 gram, konform nenit 269 par.3 të KPRK-së.
- V. Obligohen te akuzuarit që secili veç e veç të paguajnë të gjitha shpenzimet procedurale dhe atë për paushallin gjyqësor në shumë prej 20.00 (njëzet) Euro, në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 20.00 (njëzetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.5043/23 te datës: 14.02.2024, ndaj të akuzuarve A.M dhe L.S për shkak të veprës penale “Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269, paragrafi 2, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor me arsyetimin se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal, që vërtetojnë faktin se te pandehurit e lartë cekur kane kryer veprën penale e cila i ‘u vihet në barrë, ose në qoftë se gjykata nuk e shqipton urdhrin ndëshkimor, ka propozuar që të caktojë dhe mbajë seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata pasi shqyrtoi përmbajtjen e aktakuzës me kërkesën për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor nga ana e organit të ndjekjes, gjeti se e njëjta është përpiluar në përputhje me nenin 493 të KPRK-së, andaj erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet nga neni 495 i KPRK-së, që në këtë çështje penale pa u mbajtur fare shqyrtimi gjyqësor të marrë vendim për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor ndaj të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lartë, gjykata konstaton se te akuzuarit, janë penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale “Posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269, paragrafi 2, të KPRK-së, ngase veprimet e te akuzuarve i përmbajnë elementet e veprës penale e cila i ‘u ngarkohet, kjo është vërtetuar, duke u bazuar edhe në prova të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Kallëzimi Penal 2023-AC-0940, i datës 25.07.2023, raporti fillestar i incidentit i datës 07.07.2023, Procesverbali i marrjes në pyetje te dyshuarit i datës 07.07.2023, Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit i datës 07.07.2023, Raport i Ekspertit me nr. AKF/2023-3089/23-2915 i datës 20/12/2023, si dhe shkresat e tjera të cilat gjenden në lëndë. Të gjitha këto janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe rrjedhimisht bazuar në të lartcekurat, gjykata konsideron se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë, ashtu siç është propozuar nga

prokurori i shtetit në kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor, mund të arrihen qëllimet e dënimit nga neni 38 i KPRK-së.

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 69, 70 të KPRK-së.

Urdhërimi i konfiskimit të përhershëm i substancës narkotike të llojit kokaine, me peshë neto 0.20/0.0001 gram., kokaine e përzier me benzocaine, acetaminofen (paracetamol), kafeine dhe propyphenazone me peshe neto prej 0.05/0.0001 gram. Si dhe kanabis (Marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC) në peshë neto prej 0.96.0.0001 gram, është bërë konform nenit 269 par.3 të KPRK-së, ku nga paragrafi.3 citohet se: *“Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen”*. Si dhe lidhur me dispozitat e nenit 276 të KPPRK-së, pasuria që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit nga par.1 citohet se: *“Pasuria që është qenësish e rrezikshme ose e paligjshme i nënshtrohet konfiskimit, në cilëndo fazë të procedurës nga gjyqtari kompetent, pa marrë parasysh fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit dhe pavarësisht nëse prokurori i shtetit e ka ndërmarrë apo jo ndonjë veprim për ta konfiskuar pasurinë. Poseduesi, shfrytëzuesi ose i pandehuri nuk ka të drejtë ankese”, ndërsa nga par.2 pika 2.4 citohet se: kimikatet, fabrikat, pajisjet laboratorike apo substancat e krijuara apo të përdorura në veprën penale nga nenet 267-274 të Kodit Penal, andaj gjykata mbi bazën e kësaj ka bërë konfiskimin e substancës narkotike.*

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 452, par. 1 të KPPRK-së ndërsa lidhur taksën për programin e kompensimit të viktimave u mor komfor nenit 39 par 3, pika 3.1, të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit (Ligji nr. 08/L-109).

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 364, 365, 452, 462, 493, 495, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal
P.nr. 274/24, datë: 28.02.2024

Bashkëpunëtori Profesional:
Asdren Selmani

Gjyqtari:
Sabit Sadikaj

KËSHILLË JURIDIKE: I akuzuari ose mbrojtësi i tij, në afat prej tetë (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimorë, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.